

Belfjore Zifla (Qose) (1985–) Lektore dhe kërkuese shkencore pranë departamentit të letërsisë, në Universitetin e Tiranës, në lëndët e letërsisë së huaj. Ka mbaruar studimet e larta në vitin 2007, në “Gjuhë – letërsi” (studime 4-vjeçare), pranë departamentit të letërsisë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, me notë mesatare 9.5. Më 2011 ka përfunduar masterin e nivelit të dytë në “Studime letrare”, pranë të njëjtit institucion, ku diploma është shoqëruar me vlerësimin “Student i dalluar”, për rezultate të larta. Në 2015 ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor i shkencave” në *letërsi* pranë departamentit të letërsisë, në UT, me mikrotezën “Shtresa fantastike dhe pozicionimi në drejtime letrare, në romanin 'Kënga shqiptare' të K. Trebeshinës”. Ka punuar në Universitetin “A. Moisiu” si lektore me angazhim të pjesshëm e lëndëve: “Teori letërsie”, “Metodat e kërkimit shkencor”, “Letërsi e Rilindjes”, “Shkrim akademik”, “Fonetikë” (2009–2016) dhe në Universitetin “Bedër”, në lëndët: “School spelling and grammar I, II”, “Language and Literacy Development I, II” (në gjuhën angleze). Ka punuar si specialiste për arsimin e lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (2014–2015), në sektorin e hartimit të politikave dhe cilësisë.

Ka marrë pjesë me kumtesa në disa konferenca dhe botime shkencore, si: “Kriza njerëzore dhe tëhuajësimi në dramën e Trebeshinës”, në “Java e Albanologjisë” (Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017); “Heterogjeniteti i rrëfimit dhe shumësia e interpretimeve në romanin 'Viti i mbrapshtë'”, “Studia Kadareiana, Albanica et Humanitatis (Departamenti i letërsisë, UT, 2016); “Sistemi letrar dhe ekzili, çfarë përcakton marrëdhënien e një veprë me sistemin”, Java e Albanologjisë (Universiteti i Tetovës, 2016); “Koncepti i tjetrit si përjashtim dhe si vetëpërjashtim tek “'Odin Mondvalsen' i K. Trebeshinës”, (Seminari Ndërkombëtar i Prishtinës për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 2016); “Rindërtimi i së shkuarës përmes narracionit të ndërfutur brenda intervistës, si procedim origjinal i jetëshkrimit të Petro Markos”, Java e Albanologjisë (Instituti i Albanologjisë, Prishtinë, 2016); “Privimi i individit nga ndjenjat dhe vetmia, në emër të stabilitetit shoqëror në romanin 'Më e mira e botëve'”, “ICRAE 2015”; “Erotizmi dhe simbolika e marrë nga antikiteti në poezinë e L. Ahmetit”, “Seminari IX Ndërkombëtar i Albanologjisë” (Tetovë, 2015); “Procesi i studimit të fantastikes në romanet e Trebeshinës” (QSA, 2015); “Si krijohet realiteti i letërsisë bashkëkohore shqipe nisur nga informimi mediatik” (“Bedër”, 2015); etj.

Ka botuar në disa revista shkencore shqiptare dhe të huaja, artikuj shkencorë, si: "Narracioni i shtresës fantastike në romanin 'Kënga shqiptare' të Trebeshinës", në “Gjurmime Albanologjike” (Prishtinë, 2014), “Marrëzja dhe përjashtimi nga shoqëria në romanin 'Mjeshtri dhe Margarita’”, në “Filologji” (Prishtinë, 2013), “Simbolika e këngës në romanin 'Kënga shqiptare'”, në “Studime Filologjike” (QSA, 2012), “Personazhi i Ponc Pilatit në romanin 'Mjeshtri dhe Margarita' krahasuar me tekstin biblik”, në “9 maji” (Bukuresht, 2013), “Krahasimi i receptimit të kritikës se Kutelit dhe Malokit mbi veprën e Poradecit”, në “Haemus” (Bukuresht, 2013), “Figura e Ponc Pilatit në romanin “Mjeshtri dhe Margarita”, në “Kairos” (Zagreb, 2013), “Ëndrrat ndërmjet interpretimit magjik dhe atij psikanalitik në romanin 'Kënga shqiptare' të Trebeshinës, në “Albanologjia” (Tetovë, 2015), “Kohorja dhe krijimi i fantastikes në tregimet e K. Trebeshinës”, në “Jeta e re”, (Prishtinë, 2015), “Katër metoda të analizës së romanit 'Mjeshtri dhe Margarita' të Bullgakovit”, në “BES” (Tiranë, 2013) etj.

Gjatë muajit tetor 2016 ka marrë pjesë në një program kërkimor në nivel postdoktoral në Universitetin “Alexandru Ioan Cuza” në Iasi të Rumanisë, për veprën e M. Eliade dhe I. P. Culianu, në lidhje me studimet e tyre për spiritualitetin dhe fantastiken.